

Zyrtare: Shqipëria miqësore me Ukrainën

nga Administrator

E mërkurë, 06 Prill 2016 15:52



Kombëtarja shqiptare ka konfirmuar se me datë 3 qershor 2016 do të zhvillojë një ndeshje miqësore me ekipin e Ukrainës. Ndeshja do të luhet në Itali në stadiumin Atleti Azzuri të Bergamos. Ky do të jetë një test i rëndësishëm për trajnerin De Biasi para fillimit të europianit francez. Ashtu si edhe kombëtarja jone edhe Ukraina merr pjesë në Euro 2016. Duke parë numrin e madh të shqiptarëve që jetojnë në veri të Italisë, pritet që në këtë takim të ketë një numër të madh tifozesh.